



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica Sou



DREJTORIA PËR SHËNDETËSI

RAPORTI

Janar – Qershor 2026

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA

02 01-052/01-0041808/96

Idr i Kujdesit 20.07.2026

Drejtoria Mitrovicë - Mitrovica

DATË/A:	17.07.2026
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Faton Peci Kryetar i Komunës së Mitrovicës
CC:	Sekretaria e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Drejtoreshë për Shëndetësi znj. Albina Kastrati Rama
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Drejtorisë për Shëndetësi janar-qershor 2026



MITROVICË

2026

Përmbajtja:

1. Hyrje.
2. Baza ligjore.
3. Detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorisë së Shëndetësisë.
4. Organizimi i Drejtorisë.
5. Objektivat e Drejtorisë së Shëndetësisë.
6. Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese .
7. Takime nderinstitucionale, aktivitete e punëtori profesionale.
8. Vizita në institucionet shëndetësore.
9. Buxheti dhe realizimi financiar.
10. Donacionet.
11. Vizitat dhe shërbimet e realizuara në QKMF (shtojcë).

1. Hyrje

Ky raport paraqet aktivitetet, angazhimet dhe rezultatet e arritura nga Drejtoria e Shëndetësisë gjatë periudhës janar–qershor 2026, duke ofruar një pasqyrë të plotë të punës së realizuar në fushën e kujdesit parësor shëndetësor. Raporti përfshin aktivitetet institucionale dhe profesionale të Drejtorisë, menaxhimin dhe realizimin financiar, investimet e realizuara, të dhënat statistikore të shërbimeve shëndetësore.

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria e Shëndetësisë ka qenë e përkushtuar në përmbushjen e objektivave të saj strategjike përmes forcimit të bashkëpunimit ndërinstitutional, mbështetjes së zhvillimit profesional të stafit shëndetësor, promovimit të masave parandaluese dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët. Përmes koordinimit të aktiviteteve me institucionet relevante dhe zbatimit të politikave shëndetësore, është synuar rritja e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve në të gjitha njësitë e kujdesit parësor shëndetësor në komunë.

2. Baza ligjore

Veprimtaria e Drejtorisë së Shëndetësisë ushtrohet në përputhje me Kushtetutën legjislaconin në fuqi të Republikës së Kosovës, i cili rregullon organizimin dhe funksionimin e sistemit shëndetësor dhe kompetencat e nivelit lokal në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet puna e Drejtorisë së Shëndetësisë përfshin:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale,
- Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi;
- Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë;
- Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse;
- Udhëzimet administrative dhe aktet nënligjore të Ministrisë së Shëndetësisë;

Në përputhje me bazën ligjore të lartcekur, Drejtoria e Shëndetësisë ushtron kompetencat e saj në planifikimin, organizimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e kujdesit parësor shëndetësor, me synim ofrimin e shërbimeve cilësore, efikase dhe të qasshme për të gjithë qytetarët.

3. Drejtoria për Shëndetësi

Drejtoria e Shëndetësi kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:

- 3.1. Sigurimin dhe zbatimin e kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve, obligohet të zbatojë me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor;
- 3.2. Harton strategjitë për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuara në nivel lokal duke u dhënë prioritet masave parandaluese, në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinisë, pozitës ekonomiko-sociale të qytetarëve, kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor, kushteve teknologjike, mjekësore, distancës, konfiguracionit gjeografik, dhe përbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- 3.3. Harton Planin operativ të zhvillimit të kujdesit parësor shëndetësor, plani i procedohet Kuvendit të Komunës për miratim paraprak dhe e miraton Ministria në propozim të Kuvendit të Komunës, në pajtim me planin afat-mesëm të miratuar nga Qeveria;
- 3.4. Organizon dhe zbaton mbikëqyrjen profesionale, juridike dhe financiare të shëndetësisë primare;
- 3.5. Vlerëson nevojat dhe përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
- 3.6. Planifikon, harton dhe menaxhon buxhetin e kujdesit primar shëndetësor, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- 3.7. Vlerëson nevojat lokale për shëndetësinë primare;
- 3.8. Zbaton dispozitat ligjore dhe Rregulloret komunale në fushën e shëndetësisë primare;
- 3.9. Mbikëqyr situatën epidemiologjike në nivel të Komunës;
- 3.10. Kujdesin shëndetësor mendor të bazuar në bashkësi;
- 3.11. Mbikëqyrë dhe koordinon Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF);
- 3.12. Monitoron dhe kërkon raportime periodike dhe vjetore nga QKMF;

- 3.13. Ndërmerr fushata sensibilizuese me faktor tjerë dhe organizata në drejtim të preventivës dhe ruajtjes së shëndetit për qytetarët e Komunës;
- 3.14. Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- 3.15. Zbaton vendimet e Kryetarit dhe vendimet e Kuvendit Komunal;
- 3.16. Ushtron kompetenca të tjera dhe përgjegjësi duke zbatuar dispozitat ligjore, Statutin e Komunës, dhe aktet tjera nënligjore të Institucioneve të nivelit qendror;
- 3.17. Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, institucionet në nivel parësor të kujdesit shëndetësor do të sigurojnë bashkëpunimin ndërsektoral me shërbimet e mirëqenies sociale, me shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurisë publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare qeveritare e joqeveritare;

4. Organizimi i Drejtorisë së Shëndetësisë

Drejtoria e Shëndetësisë, detyrat dhe përgjegjësit e veta i ushtron përmes:

4.1. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare;

4.2. Sektori për Administratë në Shëndetësi

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

4.1. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:

4.1.1 Ruajtja dhe përparimi i shëndetit të popullatës së Komunës së Mitrovicës;

4.1.2 Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të qasshme grupeve të cënueshme, si dhe personave me nevoja të veçanta;

4.1.3. Ofrimin e shërbimeve shëndetësore në rrjetin e institucioneve shëndetësore për popullatën e Komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës;

4.1.4. Sigurimin e burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe kompetente për ofrim të shërbimeve cilësore në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor;

4.1.5. Sigurinë dhe funksionalitetin e rrjetit të institucioneve shëndetësore;

4.1.6 .Sigurinë e personelit dhe pacientëve përgjatë procesit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore;

4.1.7 Vlerësimin dhe monitorimin i shërbimeve cilësore dhe kosto-efikase;

4.1.8 Riorganizimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore në situata të jashtëzakonshme emergjente;

4.1.9 Trajtimi dhe menaxhimi i kërkueseve të shërbimeve të bazuara në praktikat më të mira shkencore;

4.1.10 Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik të popullatës së Komunës së Mitrovicës përmes vaksinimit dhe imunizimit të popullatës bazuar në rekomandimet e IKSHP/MSH;

4.1.11. Promovimin shëndetësor; përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin brenda institucioneve dhe në komunitet;

4.1.12. Përfshirja dhe pjesëmarrja aktive e shfrytëzuesve, popullatës, në procesin e planifikimit

dhe vlerësimit të shërbimeve shëndetësore si dhe pjesëmarrja në proceset e vendim marrjes;

4.1.13. Realizimin e buxhetit të QKMF-së;

4.1.14. Bashkëpunimin dhe kooperimin me DSH dhe të gjitha palët e interesit.

4.2. Sektori për Administratë në Shëndetësi

Sektori për Administratë në Shëndetësi kryen këto detyra dhe është përgjegjëse për:

4.2.1. Ndhmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës, për përmbushjen e këtyre objektivave, si dhe përgatitë planin dhe raportet e punës për sektorin;

4.2.2. Asiston në hartimin e strategjisë shëndetësore, vlerësimin e nevojave lokale në aspektin Shëndetësor;

4.2.3. Planifikon, Përgatitë, analizon, rekomandon dhe monitoron Buxhetin e Drejtorisë për shëndetësi si dhe institucioneve shëndetësore të cilat i raportojnë Drejtorisë;

4.2.4. Koordinon punët me sektorët brenda Komunës dhe institucioneve varëse që kanë mundësi për zgjidhje;

4.2.5. Kujdeset, monitoron dhe vlerëson gjendjen infrastrukture të institucioneve shëndetësore , në bashkëpunim me drejtorin dhe menaxhmentin e QKMF-së planifikon renovimet dhe ndërtimet e reja të objekteve shëndetësore;

4.2.6. Bën planin dinamik të realizimit të projekteve;

4.2.7. Monitoron, mbikëqyrë institucionet varës në aspektin shëndetësor, financiar dhe ligjor;

4.2.8. Në bashkëpunim me drejtorin bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;

4.2.9. Përgatitë shkresa, propozim vendime, aktet tjera që lidhen me natyrën e punës në Drejtori;

5. Objektivat e Drejtorisë Shëndetësisë

Objektivi 1. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve shëndetësore

5.1 Furnizimi i mirë me barna, reagjensa, material mjekësor, pajisje mjekësore dhe inventar i QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve

Gjatë periudhës janar-qeshor, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare është furnizuar me barna, material laboratorik, material stomatologjik, reagjensa për laborator mjekësor, pajisje mjekësore si dhe material administrativ, me qëllim të plotësimit të nevojave të pacientëve .

5.2. Furnizimi me Oksigjen Medicinal

Pas përfundimit të gjitha procedurave të prokurimit, është nënshkruar kontrata kornize për Furnizim me Oksigjen Medicinal, i cili do të lehtësojë ofrimin e shërbimeve shëndetësore, sidomos nevojave të paraqitura në Urgjence dhe furnizimin me oksigjen të Autoambulancave.

5.3. Fillimi i ofrimit të shërbimit Geriatrik

Me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore primare, Drejtoria për Shëndetësi ka filluar ofrimin e shërbimit geriatrik, ku përshihen këto shërbime:

KOMUNA E MITROVICËS
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI

SHËRBIMI GERIATRIK

KUJDES SHTËPIAK PËR TË MOSHUARIT (65+)

Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore primare, Drejtoria për Shëndetësi ka funksionalizuar Ekipën Geriatrike për kujdes shëndetësor në shtëpi.

Kush përfiton dhe çfarë sëmundjesh trajtohen?

- Për të gjithë qytetarët mbi 65 vjeç që kanë nevojë për kujdes shëndetësor në shtëpi
- ✓ Sëmundje kronike (Hipertensioni, Diabeti, etj.)
- ✓ Probleme kardiake
- ✓ Osteoporozë & probleme të lëvizjes
- ✓ Sëmundje neurodegenerative (Alzheimer, Parkinson, Demenca, etj.)
- ✓ Gjendje të tjera shëndetësore sipas vlerësimit mjekësor


Shërbimet që ofrohen:

Dhënia e terapiës intravenoze (infuzione të përshkruara nga mjekët specialistë)	Infuzione të përshkruara nga mjekët specialistë
Injektime intramuskulare dhe subkutane	Kateterizim urinar (vendosje & ndërrim)
Pastrimi dhe trajtimi i plagëve dhe dekubitit aq sa është e nevojshme nga kujdesi primar	

Nr. Tel: +383 44 249 330
Orari: E hënë – E premte | 07:00 – 15:00

5.4. Funksionalizohet ordinanca e fëmijëve ne sektorin e stomatologjisë, në kuadër të QKMF-së

Pas pranimit të dy karrigeve stomatologjike donacion nga familja Pireva, është funksionalizuar dhoma stomatologjike, e cila është e dedikuar vetëm për ofrimin e shërbimeve stomatologjike për fëmijët, këto shërbime do të ofrohen nga specialistët e pedodoncisë.



5.5 Funksionalizohet dhoma e shërbimit esencial kurativ dhe ndërhyrjeve të vogla kirurgjike në objektin e QKMF-së Mitrovicë

Bazuar në Udhëzimin Administrativ, Kujdesit Parësor Shëndetësor, QKMF, në Mitrovicë ka filluar ofrimin e shërbimit esencial kurativ dhe ndërhyrjeve të vogla kirurgjike.

Këtu përfshihen ofrimin i këtyre shërbimeve:

LIDHTORE

(Kirurgji e vogël)

Përpunimi, pastrimi dhe fashimi i plagëve dhe lëndimeve të vogla trupore.



Objektivi 2: Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Drejtoria për Shëndetësi, pas mbarimit të mandatit (me pensionim) të drejtorit të QKMF-së, me qëllim të vazhdimit të punës të menaxhmentit, është caktuar U.D Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni”.

Gjithashtu, me qëllim të mbarvajtjes së punës menaxheriale, pozitë ku është dashur të rregullohen janë plotësuar me staf profesional.

5.6. Drejtoria për Shëndetësi ka vazhduar me organizimin dhe përkrahjen e aktiviteteve në kuadër të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional të personelit shëndetësor

Me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Parësor Shëndetësor të Mitrovicës.

Krahas aktiviteteve që Zhvillohen sipas planit të punës së koordinatorëve të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional , Drejtoria për Shëndetësi ka përkrahur ose ka organizuar edhe shumë aktivitete të tjera për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional të profesionistëve shëndetësor që punojnë në (KPSH).

5.7 .Pjesëmarrja e personelit të Sektorit të Urgjencës, në trajnimin e organizuar në Campin Bondsteel

Punëtorët e Sektorit të Urgjencës, së bashku me departamentin e zjarrëfiksëve kanë marrë pjesë në trajnimin e përbashkët, i cili është mbajtur në campin Bondsteel, në bashkëpunim me Task Forcën Mjekësore të KFOR-it, me fokus në mbështetjen bazë të jetës (BLS), kujdesin taktik në

emergjenca (TECC), triazhimin START, menaxhimin e lëndimeve mjedisor edhe reagimin ndërinstitutional.

Si vazhdimësi e këtij trajnimi punëtorët e Sektorit të Urgjencës, në bashkëpunim me instruktorët e Camp Bondsteel, në hapësirat e QKMF, kanë relaizuar trajnimin me temën “Mbështetja Bazë e Jetës (BLS) dhe Menaxhimi i Avancuar i Rrugëve të Frymëmarrjes”, duke përfshirë reanimimin kardiopulmonar, përdorimin e AED-së, ventilimin me balonë dhe maskë, pajisjet supraglotike dhe intubimin endotrakeal.



Objektivi 3: Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore

5.8. Përfundimi i renovimit të AMF-së Fidanishtë,

Pas përfundimit të renovimit të objektit të AMF- Fidanishtë, ka rifilluar ofrimimi i shërbimeve shëndetësore në ambulancë mjekësore.

5.9. Lirimi i hapësirës të oborrit të QMF- Bair 2

Pas një periudhe të gjatë kohore, është liruar hapësira mbrapa objektit të QMF- Bair2, e cila ka qenë e uzurpuar nga personat fizik.

Lirimi i kësaj hapësire, ka lehtësuar mbarvajtjen e punës në këtë qendër.



5.10 Furnizim me pajisje elektroshtëpiake në rrjetin e KPSH-së

Me qëllim të plotësimit të nevojave të institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor, këto institucione janë furnizuar me pajisje elektro-shtëpiake, sipas kërkesave të parashtruara.

Këto pajisje përfshijnë: Frigorifer për vaksinim dhe nevojat e tjera, kondicioner, aparati për ngrohje/ftohje të ujit të cilat do të shërbejnë për nevojat e stafit dhe pacientëve.

5.11. Furnizimi i stafit shëndetësor me veshmbathje pune

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të punës dhe garantimit të standardeve profesionale, është realizuar furnizimi i stafit shëndetësor me veshmbathje pune, në përputhje me nevojat e institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor.

Objektivi 4 : Aktivitetet për parandalimin e sëmundjeve

Një prej objektivave kryesore të Drejtorisë për Shëndetësi është ndërmarrja e masave dhe zhvillimi i aktiviteteve për parandalimin e sëmundjeve përmes fuqizimit të Komponentës së Edukimit Shëndetësor dhe Promovimit të Shëndetit në kuadër të KPSH-së por edhe masave të tjera siq janë këshillimi, informimi, sensibilizimi dhe motivimi për jetë të shëndetshme dhe mbrojtje të shëndetit.

5.12. Sigurimi i hapësirës për realizimin e praktikës profesionale për nxënësit e Shkollës së Mjekësisë.

- Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë për Shëndetësi dhe Komunës së Mitrovicës, është siguruar një sallë në objektin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), e cila do të shfrytëzohet nga nxënësit e Shkollës së Mjekësisë “Dr.Xheladin Deda”, për realizimin e praktikës profesionale.
- Kjo hapësirë do t’u mundësojë nxënësve zhvillimin e aktiviteteve praktike mësimore, në përputhje me planin dhe programin mësimor, duke kontribuar në krijimin e kushteve më të mira për përgatitjen dhe aftësimin e tyre profesional në fushën e shëndetësisë.



6. Organizimi i aktiviteteve sensibilizues

6.1. “JAVA E SHËNDETIT ORAL 2026”

Drejtoria për Shëndetësi, QKMF, Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta si dhe Rotary Club, me qëllim të ndërgjegjësimin, edukimit shëndetësor dhe promovimit të shëndetit oral, kanë organizuar **“JAVËN E SHËNDETIT ORAL 2026”**

Me qëllim të shënimit të kësaj jave, janë mbajtur ligjërata edukative shëndetsore dhe aktivitete të tjera për rëndësinë e shëndetit oral dhe higjienës orale në rreth 15 Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta si dhe fëmijë e organizatë Handikos- Mitrovicë.

Ndërsa, Rotary Club, ofrojë dhurata higjenike për nxënësit pjesmarrës të këtyre aktiviteteve.

Ligjërata janë mbajtur nga stomatologët, asistentët dentarë dhe infermierët e Sektorit të Shëndetit Oral dhe Njësisë për Edukim Shëndetsor dhe Promovim të Shëndetit të QKMF-së, nga data 23.03.2026 deri me datën 27.03.2026.

Raporti janar-qershor 2026 Drejtoria për Shëndetësi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Shëndetësi



"DITA BHOTË EORË E SHËNDETËSISË ORALE 20 MARS"

Drejtoria për Shëndetësi e Komunës së Mitrovicës në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare shpaloj agjenden e vës për aktivitetet që do të mbahen në kuadër të shënimit të javës së shëndetit oral si vijojnë:

Datë:	Ora	Bartësi	Aktiviteti	Vendi	Stafi
E hënë	13:30	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U. - "Migjeni"	Dr.spc.Zana Beqiri As.Dafina Hajdari
	13:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët- kl e para	SH.F.M.U. - "Fazli Greicevci"	Dr.Qefserë Mehmeti As.Luljeta Ombashi
23.03.2026	13:00	QKMF	Higjiena Orale -Rëndësia e kujdesit ndaj shëndetit oral- kl e pesta	SH.F.M.U. - "Fazli Greicevci"	Dr.Qefserë Mehmeti As.Luljeta Ombashi
E martë	12:45	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët- kl e para	SH.F.M.U. - "Avdullah SHabani"	Dr.Arjon Selimi As.Fikrije Osmani
24.03.2026	13:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët- kl e para	SH.F.M.U. - "Bedri Gjinaj"	Dr. Ardita Abiti As.Lindita Miftari
	13:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U. - "Musa Hoti"	Dr.spc.Zana Beqiri As.Dafina Hajdari
	9:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U. - "Musa Hoti" paralelja Frashër	Dr.spc.Zana Beqiri As.Dafina Hajdari
	13:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U. - "Eqrem Çabej"	Dr.Qefserë Mehmeti As.Luljeta Ombashi
E mërkurë 25.03.2026	13:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U. - "Shaban Idrizi"	Dr.Selma Bekteshi As.Vlora Kurti
	9:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U. - "Mehë Uka"	Dr. Ardita Abiti As.Lindita Miftari
	9:00	QKMF	Higjiena Orale -Rëndësia e kujdesit ndaj shëndetit oral- kl e pesta	SH.F.M.U. - "Mehë Uka"	Dr. Ardita Abiti As.Lindita Miftari
	10:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrim i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U. - "Xhevat Jusufi"	Dr.spc.Zana Beqiri As.Dafina Hajdari

Raporti janar-qershor 2026 Drejtoria për Shëndetësi

	10:00	QKMF	Higjiena Orale -Rëndësia e kujdesit ndaj shëndetit oral- kl e pesta	SH.F.M.U.-"Xhevat Jusufi"	Dr.spe.Zana Beqiri As.Dafina Hajdari
E enjte 26.03.2026	12:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrimi i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U.-"Ismajl Qemajli"	Dr.Arjon Selimi As.Fikrije Osmani
	10:00	QKMF	Higjiena Orale -Rëndësia e kujdesit ndaj shëndetit oral- kl e pesta	SH.F.M.U.-"Ismajl Qemajli"	Dr.Arjon Selimi As.Fikrije Osmani
	13:00	QKMF/ Njësia e edukimit dhe e promovimit shëndetësor	Higjiena Orale -Demonstrimi i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U.-"Xhiz Sylejmani"-Suhodoll	Inf. Hava Rexha Inf. Albulena Ramadani
	10:00	QKMF/ Njësia e edukimit dhe e promovimit shëndetësor	Higjiena Orale -Rëndësia e kujdesit ndaj shëndetit oral- kl e pesta	SH.F.M.U.-"Trepca"	Inf. Hava Rexha Inf. Albulena Ramadani
	11:00	QKMF	Higjiena Orale -Demonstrimi i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët	"Handikos"	Dr.Qefere Mehmeti As.Luljeta Ombashi
E premte 27.03.2026	13:00	QKMF/ Rotary Club	Higjiena Orale -Demonstrimi i rregullt i pastrimit të gojës tek fëmijët-kl e para	SH.F.M.U.- "Skënderbeu"	Dr.Selma Bekteshi As.Vlora Kurti
	13:00	QKMF/ Rotary Club	Higjiena Orale -Rëndësia e kujdesit ndaj shëndetit oral-kl e pesta	SH.F.M.U.- "Skënderbeu"	Dr.Selma Bekteshi As.Vlora Kurti



6.2. Shënohet Dita Botërore e Shëndetit

Me rastin e Ditës Botërore të Shëndetit, punëtorët shëndetësor të QKMF-së organizuan aktivitet në komunitetin rom, me qëllim të promovimit të shëndetit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për kujdesin shëndetësor.

Gjatë këtij aktiviteti janë realizuar matje të:

- Peshës trupore
- Glikemisë (nivelit të sheqerit në gjak)
- Tensionit arterial etj.

Gjithashtu, janë shpërndarë fletëpalosje informuese për stilin e shëndetshëm të jetesës dhe janë dhënë këshilla të ndryshme shëndetësore për pjesëmarrësit.

Pjesëmarrësit janë këshilluar për kontrolla të rregullta mjekësore dhe janë udhëzuar për ndjekje të mëtejshme tek mjeku familjar.



6.3. Shënohet Dita Botërore e Tokës

Me rastin e ditës së tokës, Drejtoria për Shëndetësi, i është bashkangjitur iniciativës për shënimin e kësaj dite, ku janë pastuar oborret e institucioneve shëndetësore dhe janë mbjellur fidane në këto hapësira, këtyre aktivitetve i janë bashkuar dhe punëtorët shëndetësor të KPSH.



6.4. Shënohet Java e Imunizimit 2026

Drejtoria për Shëndetësi, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, kanë shënuar “Java e Imunizimit 2026”, e cila këtë vitë është zhvilluar me moton: “Vaksinat mbrojnë të gjitha moshat”.

Drejtoria për Shëndetësi me ekipet mjekësore i është bashkuar kësaj nisme të rëndësishme, duke realizuar aktivitetet në kuadër të kësaj jave me qëllim të rritjes së vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e vaksinimit.

Gjatë kësaj jave janë zhvilluar aktivitete të ndryshme informuese dhe sensibilizuese, të cilat kanë synuar promovimin e vaksinimit si një ndër masat më efektive për parandalimin e sëmundjeve dhe mbrojtjen e shëndetit publik për të gjitha grupmoshat.

Gjithashtu, Drejtoria për Shëndetësi, ka organizuar një tryezë diskutimi për rritjen e ndërgjegjësimit mbi vaksinimin e fëmijëve, me fokus në moshën parashkollore dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse.

Në këtë aktivitet morën pjesë specialistë pediatër, përfaqësues të QKMF-së, Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik dhe drejtueset e institucioneve parashkollore.

Gjatë diskutimit u theksua rëndësia e imunizimit si masë kyçe për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve, sfidat që lidhen me hezitimin ndaj vaksinimit, si dhe rreziku nga përhapja e sëmundjeve ngjitëse, veçanërisht fruthi.

Po ashtu, u nënvizua roli i vaksinës MMR dhe rëndësia e bashkëpunimit ndër-institucional dhe angazhimit të institucioneve parashkollore në ndërgjegjësimin e prindërve.



6.5 Shënohet Dita Ndërkombëtare e Infermierisë

Drejtoria për Shëndetësi, me rastin e shënimit të kësaj dite, si shenjë falenderimi për kontributin dhe angazhimin e personelit infermieror, ka dhuruar lule për të gjithë infermierët e KPSH-së.

Me qëllim të shënimit të kësaj dite, infermieret e QKMF-së, në bashkëpunim me Shkollën e Mjekësisë, ofruan shërbime dhe këshilla infermierore në Sheshin “Mehë Uka” për komunitet.



6.6. Shënohet 17 Maj – Dita Botërore e Hipertensionit

Në kuadër të Ditës Botërore të Hipertensionit, Drejtoria e Shëndetësisë së bashku me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Instituti "Hasan Tahsin" dhe Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë "Dr.Xheladin Deda", realizuan një aktivitet vetëdijesues për rëndësinë e kontrollit të tensionit arterial. Ky aktivitet është mbajtur tek hapësira e Liqenit Akumulues – Mitrovicë.

Po ashtu personeli i QKMF-së së bashku me doktorin dhe infermieren nga KosovaMed, vizituan Shoqatën e Pensionistëve në Mitrovicë, ku i këshilluan mbi rëndësinë e trajtimit të rregullt të hipertensionit dhe diabetit,

Gjatë aktivitetit u realizuan, matja e tensionit arterial, matja e nivelit të sheqerit në gjak, kontrolla rutinë shëndetësore, këshilla profesionale për stil të shëndetshëm të jetës, edukim dhe promovim shëndetësor në komunitet.



6.7. Shënohet “Dita Botërore e Melanomës”

Me rastin e Ditës së Euro-Melanomës, stafi i Shërbimit të Dermatovenerologjisë (mjekë dhe infermierë) në Spitalin e Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" në Mitrovicë, së bashku me atë të QKMF-së, organizuan një aktivitet sensibilizues për qytetarët tanë.

Melanoma është një nga llojet më të rrezikshme të kancerit të lëkurës. Ajo zhvillohet në qelizat ku prodhohet melanina, pigmenti që përcakton ngjyrën e lëkurës sonë. Njohja e simptomave të para të këtij lloji kanceri mundëson zbulimin dhe trajtimin e tij, përpara se sëmundja të përhapet. Melanoma mund të trajtohet suksesshëm, nëse zbulohet në kohë.

Gjatë këtij aktiviteti, stafi mjekësor shpërndau fletushka informuese dhe bisedoi nga afër me qytetarët mbi rëndësinë e vetëdijesimit, mbrojtjes nga rrezet ultraviolette dhe kontrollit të rregullt të nishaneve.



6.8 “Karvani Shëndetësor” për promovimin e edukimit shëndetësor

Drejtoria e Shëndetësisë e Komunës së Mitrovicës , Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni” dhe OJQ “ Mundësia” realizuan me sukses Karvanin Shëndetësorë “përSHËNDETje” , aktivitet i dedikuar promovimit të shëndetit dhe ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e parandalimit të sëmundjeve dhe adoptimit të stileve të shëndetshme të jetesës.

Përveç informimit dhe edukimit shëndetësor, pjesëmarrësve iu ofruan edhe shërbime bazike shëndetësore, përfshirë matjen e tensionit të gjakut, kontrollin e nivelit të glukozës , BMI dhe këshillime individuale.

Karvanet shëndetësore implementohen nga OJQ “MUNDESIA” në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe QKMF , në kuadër të projektit “Kujdesi shëndetësor i qasshëm dhe cilësor” AQH , i cili zbatohet nga Swiss TPH dhe financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



6.9 . Shënohet Dita e të Drejtave të Pacientit

Me rastin e Ditës së të Drejtave të Pacientit, Drejtoria e Shëndetësisë organizoi një tryezë diskutimi, ku morën pjesë drejtori i QKMF-së, profesionistë shëndetësorë dhe Këshilli i Pacientëve. Gjatë takimit u diskutua mbi rëndësinë e trajtimit dinjitoz, informimit të drejtë dhe bashkëpunimit ndërmjet pacientëve dhe stafit shëndetësor, si elemente thelbësore për përmirësimin e shërbimeve.

Drejtoria e Shëndetësisë mbetet e përkushtuar në avancimin e cilësisë së shërbimeve dhe respektimin e të drejtave të çdo qytetari.



7. Takime nderinstitucionale, bashkëpunime, punëtori e aktivitete profesionale

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria e Shëndetësisë ka realizuar një sërë takimesh, bashkëpunimesh ndërinstitucionale, punëtorish dhe aktivitete profesionale, me qëllim të forcimit të koordinimit institucional, ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe avancimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore në nivel komunal.

7.1. Takime të rregullta me Drejtorin e QKMF-së, përgjegjësit e sektorëve, qytetarë dhe palë të tjera të interesit;

7.2. Takime dhe bashkëpunime ndërinstitucionale me Spitalin Rajonal të Mitrovicës "Dr. Sami Haxhibeqiri",

7.3. Bashkëpunime dhe takime me Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Mitrovicë,

7.4. Drejtorinë e QKMF-së, drejtoritë e tjera komunale dhe institucionet relevante në fushën e shëndetësisë,

7.5. Pjesëmarrje aktive në takimet e Kolegjiumit të Drejtorëve të Shëndetësisë të komunave në Republikës së Kosovës;

7.6. Pjesëmarrje aktive në Grupin Punues në Planin e Veprimit për Funkcionalizimin e Poliklinikave Stomatologjike;

7.7. Pjesëmarrje në punëtorinë në Programin e Ndërhyrjes e Hershme në Fëmijëri -NFH;

7.8. Pjesë e Grupit Punues Ad Hoc në kuadër të Projektit III AQH;

7.9. Punëtorinë "Qëndrueshmëria e Ndërhyrjeve të Projektit AQH – Dhomat për Edukim dhe Promovim Shëndetësor për Menaxhimin e Sëmundjeve Kronike Jo-ngjitëse dhe Programet Përkatëse të Trajnimit".



Raporti janar-qershor 2026 Drejtoria për Shëndetësi





8. Vizita në institucionet shëndetësore (QKMF, QMF dhe AMF)

- Drejtoria e Shëndetësisë ka realizuar vizita të vazhdueshme në QKMF, QMF dhe AMF, me qëllim të monitorimit nga afër të punës së stafit shëndetësor, vlerësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara, si dhe identifikimit të nevojave dhe sfidave në ofrimin e kujdesit shëndetësor.







9. Buxheti dhe realizimi financiar

9.1. Raporti financiar i Drejtorisë për Shëndetësi, përfshirë QKMF-në

Buxheti i planifikuar për vitin 2026 ishte 4,335,886.00 €, prej tyre:
 3,651,356.00 € nga Granti specifik i shëndetësisë,
 80,000.00 € nga te Hyrat vetanake te komunës,
 604,530.00 € nga Granti i përgjithshëm i Komunës

Pershkrimi	Stafi	Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencionet	Shpenzimet Kapitale	Totali
DSH	298	2,826,584.00	887,702.00	81,600.00	80,000.00	460,000.00	4,335,886.00
Grantet Qeveritare		2,826,584.00	887,702.00	81,600.00	0.00	460,000.00	4,255,886.00
Të hyrat vetanake		00.00	0.00	0.00	80,000.00	0.00	80,000.00
Financimi i jashtëm		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
ADMINISTRATA	4	44,530.00	100,000.00	0.00	80,000.00	460,000.00	684,530.00
Grantet Qeveritare		44,530.00	100,000.00	0.00	0.00	460,000.00	604,530.00
Të hyrat vetanake		0.00	0.00	0.00	80,000.00		80,000.00
Financimi i jashtëm 22							0.00
QKMF	294	2,782,054.00	787,702.00	81,600.00	0.00	0.00	3,651,356.00
Grantet Qeveritare		2,782,054.00	787,702.00	81,600.00	0.00	0.00	3,651,356.00
Të hyrat vetanake		00.00	0.00	0.00	0.00	0.00	30,000.00
Financimi i jashtëm 22							0.00

9.2.Projektet Kapitale

Projektet Kapitale për vitin 2026 të shpërndara sipas projektëve dhe emertimeve

Programi/Emërtimi i projektit	2026	
	Granti qeveritar 10	<u>TOTAL</u> <u>2025</u>
Administrata	460,000.00	460,000.00
Pajisje Mjekesore për QKMF-ne e re (Pajisje Laboratorike, Stomatologjike, Pajisje Radiologjike dhe pajisje te Mjekesise Familjare)	300,000.00	300,000.00
Gjenerator KWA 850 per QKMF Mitrovice	110,000.00	110,000.00
Instalimi i panelave solar ne QKMF Mitrovice	50,000.00	50,000.00

9.3.Shpenizmi i Buxhetit

Buxheti i Drejtorisë së Shëndetësisë është realizuar 52.83 %

Kategoria Ekonomike	Buxheti i planifikuar me ndryshime	Shpenzimet nga Granti	Shpenzimet nga Vendimi e permbarimit	Totali i Shpenzimeve	Indexi %
Paga dhe mëditje	2,826,584.00	1,675,834.87	0.00	1,675,834.87	59.29
Mallra dhe Shërbime	887,702.00	365,658.07	103,946.97	469,605.04	52.90
Shpenzime Komunale	81,600.00	51,600.00	0.00	51,600.00	63.24
Subvencione	80,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Shpenzime Kapitale	460,000.00	0.00	93,713.71	93,713.71	20.37
Totali	4,335,886.00	2,093,092.94	197,660.68	2,290,753.62	52.83

Buxheti i Administratës së Drejtorisë për Shëndetësi është realizuar 18.52 %

Kategoria Ekonomike	Buxheti	Shpenzimet nga Granti	Shpenzimet nga Vendimi e permbarimit	Totali i Shpenzimeve	Indexi %
Paga dhe mëditje	44,530.00	25,174.89	0.00	25,174.89	56.53
Mallra dhe Shërbime	100,000.00	7,904.29	0.00	7,904.29	7.90
Shpenzime Komunale	0.00		0.00	0.00	#DIV/0!
Subvencione	80,000.00		0.00	0.00	0.00
Shpenzime Kapitale	460,000.00		93,713.71	93,713.71	20.37
Totali	684,530.00	33,079.18	93,713.71	126,792.89	18.52

Buxheti i QKMF-së është realizuar 59.26%

Kategoria Ekonomike	Buxheti	Shpenzimet nga Granti	Shpenzimet nga Vendimi e permbarimit	Totali i Shpenzimeve	Indexi %
Paga dhe mëditje	2,782,054.00	1,650,659.98	0.00	1,650,659.98	59.33
Mallra dhe Shërbime	787,702.00	357,753.78	103,946.97	461,700.75	58.61
Shpenzime Komunale	81,600.00	51,600.00	0.00	51,600.00	63.24
Subvencione	0.00		0.00	0.00	#DIV/0!
Shpenzime Kapitale	0.00		0.00	0.00	#DIV/0!
Totali	3,651,356.00	2,060,013.76	103,946.97	2,163,960.73	59.26

9.4. Procedurat në prokurim

Gjatë periudhës Janar – Qershor janë proceduar për kontrata në prokurim këto aktivitete

Përshkrimi i Kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës
Furnizime mjekesore	1,500,000.00
Furnizim me gjenerator	110,000.00
Furnizim me panela solar	110,000.00
Furnizim me material administrativ mjekesor	210,000.00
Sherbimet e pastrimit te QKMF	210,000.00

9.5. Subvencionet

Drejtoria për Shëndetësi nga data 07.04.2026 deri me datën 06.05.2026 ka hapur aplikimin për mbështetjen financiare për shpenzime me barna dhe trajtime mjekësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Mitrovicës.

Gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar 1314 aplikantë, gjithsej janë subvencionuar 639 qytetarë, duke pasur prioritet të sëmuret me sëmundje kanceroze ku shuma totale ka arritur në vlerë prej 74,000.00€.

9.6. Shqyrtimi i lëndëve në Intranet

Drejtoria për Shëndetësi, për periudhen Janar – Qershor, në intranet janë realizuar 1387 kërkesa, të cilat janë parashtruar nga personat fizik dhe juridik të cilat janë duke u trajtuar në vazhdimësi.

10. DONACIONET

Donacion 1

Drejtoria e Shëndetësisë, ka pranuar donacion nga KOSOVAMED HEALTHCARE SH.P.K . për nevojat e QKMF "Dr. Nexhat Çuni" në Mitrovicë.

Ky donacion përfshinë 2 OXYGEN CONCENTRATOR 5L dhe 3 INHALATOR (NEBULIZER), paisje të nevojshme për avancimin e shërbimeve shëndetësore



Donacioni 2

Drejtoria e Shëndetësisë, ka pranuar donacion dy karrige stomatologjike nga familja Pireva, donacion i realizuar në kujtim të vajzës së tyre të ndjerë, Atikës.

Ky kontribut me vlerë të veçantë humane do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve për pacientët tanë.

Emri i Atikës do të jetojë në çdo buzëqeshje dhe kujdes që do të marrin fëmijët e qytetit të Mitrovicës falë këtij donacioni.



11. Vizitat dhe shërbimet e realizuara në QKMF, QMF dhe AMF

Vizitat dhe shërbimet në kuadër të QKMF "Dr. Nexhat Çuni" në Mitrovicë të ndara sipas shërbimeve organizative periudha janar-qershor 2026																
#	SHËRBIMI I MJEKËSISË FAMILJARE		SHËRBIMI URGJENT		VAKSINIMI DHE IMUNIZIMI		SHËRBIMI I SHËNDETI ORAL		LABORATORI BIOKIMIK		KABINETI RTG		BARNATORIA QENDRORE		GJITHSEJ	
	vizita	shërb	vizita	shërb	vizita	shërb	vizita	shërb	vizita	shërb	vizita	shërb	vizita	shërb	vizita	shërb
janar	11200	14413	3460	6246	475	1067	1097	3597	2519	60626	216	300	1471	4643	20438	90892
shkurt	11486	14203	2702	5007	297	651	1608	4008	2556	64543	270	440	1260	1805	20179	90657
mars	11587	14625	3034	5854	394	847	1187	3842	2282	53919	251	450	1552	2248	20287	81785
prill	12063	15142	3039	5643	200	369	1118	3249	2516	66419	252	400	3589	4738	22777	95960
maj	10767	13748	3159	5932	478	970	1106	3191	2353	64853	246	393	2896	3678	21005	92765
qershor	11886	14801	3420	6060	526	1019	915	2984	2925	69706	297	518	3268	5057	23237	100145
gjithsej	68989	86932	18814	34742	2370	4923	7031	20871	15151	380066	1532	2501	14036	22169	127923	552204